

KRU **Hidroregjioni Jugor** sh.a. Prizren

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren  
email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

Bordi i Drejtorëve i K.R.U “Hidroregjioni Jugor” Sh.A, me seli në Prizren, në përputhje me nenin 30 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike si dhe në përputhje me nenin 17 Të Ligjit Nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në mbledhjen e mbajtur me datë 31.10.2025, mori këtë:

### VENDIM

Bordi i Drejtorëve miratoi Plan Biznesin e K.R.U “Hidroregjioni Jugor” Sh.A , për vitin 2026 – 2028, në mbledhjen e mbajtur me 31.10.2025.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	<b>UD. Kryeshef Ekzekutiv Fadil Berisha</b>	<b>Kryesuesi i BD Ylber Elshani</b>
Nënshkrimi		
Data	31.10.2025	31.10.2025








KRU **Hidroregjioni Jugor** sh.a. Prizren

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren  
email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

---



# PLANI I BIZNESIT 2026 - 2028

*Tetor 2025*

## 1. Përmbajtja

1.	Mbulueshmëria.....	8
2.	HYRJE.....	9
3.	PËRMBLEDHJA E PËRGJITHSHME.....	10
3.1	Historiku i Kompanisë .....	10
3.1.1.	Fusha e shërbimeve .....	10
3.1.2.	Burimet dhe kapacitetet furnizuese .....	10
3.2	Baza Ligjore .....	11
3.3	Deklarata e Politikës .....	11
3.4	Tarifat e shërbimit.....	12
3.4.1.	Tarifat e planifikuara.....	13
3.4.2.	Pasojat dhe arsyeshmëria e rritjes së tarifës .....	16
3.4.3.	Përbalueshmëria .....	16
4.	DEPARTAMENTI I UJIT TË PIJES (DUP).....	17
4.1.	Qëllimet.....	17
4.2.	Objektivat.....	18
4.2.1.	Objektivat kryesore.....	18
4.2.2.	Aktivitetet e planifikuara për realizimin e objektivave .....	18
4.3.	Rreziqet që mund të ndikojnë në mosarritjen e caqeve.....	20
4.4.	Plani i investimeve kapitale.....	20
4.5.	Përtëritja dhe rritja e infrastrukturës .....	21
4.6.	Planifikimi i zvogëlimit të humbjeve të ujit.....	22
4.7.	Plani i menaxhimit të aseteve .....	24
4.8.	Prodhimi (m <sup>3</sup> ) 2026–2028.....	25
4.9.	Aktivitetet për zvogëlimin e UPF-së.....	26
5.	DEPARTAMENTI I UJËRAVE TË NDOTURA (DUN).....	28
5.1.	Fushë veprimtaria e Departamentit të Ujërave të Ndotura .....	28
5.2.	Qëllimet dhe objektivat kryesore .....	28
5.3.	Aktivitetet e planifikuara me qëllim të arritjes së caqeve .....	29
5.4.	Rreziqet që mund të ndikojnë në mosarritjen e caqeve.....	30
5.5.	Plani investiv .....	31
5.6.	Përtëritjet e infrastrukturës .....	31
5.7.	Rritje e infrastrukturës.....	32

5.8.	Mirëmbajtja e infrastrukturës.....	32
5.9.	Aktivitetet biznesore.....	32
5.10.	Investimet DUN.....	33
5.11.	Trajtimi i ujit të ndotur – m <sup>3</sup> (2026–2028).....	34
6.	DEPARTAMENTI KOMERCIAL.....	35
6.1.	Parashikimi i rritjes së numrit të konsumatorëve.....	36
6.2.	Numri i konsumatorëve.....	36
6.3.	Planifikimi i Faturimit (m3).....	37
6.4.	Planifikimi i Faturimit (€) 2026-2028.....	38
6.5.	Planifikimi i Arkëtimit 2026-2028.....	39
6.6.	Objektivat kryesore.....	40
6.7.	Aktivitetet kryesore të planifikuara për arritjen e objektivave nga Departamenti Komercial 40	
6.8.	Gatishmëria për të paguar.....	40
6.9.	Trendët e kërkesave më të shpeshta të konsumatorëve.....	41
6.10.	Kërkesat e performancës së shërbimit ndaj konsumatorëve.....	41
6.11.	Plani Operacional.....	42
6.11.1.	Planifikimi i zgjerimit të shërbimit.....	42
6.11.1.	Aktivitetet kryesore të planifikuara për arritjen e objektivave.....	42
6.11.2.	Aktivitetet kryesore për zvogëlimin e UPF-së – komerciale.....	42
6.11.3.	Rreziqet që mund të ndikojnë në mosarritjen e objektivave.....	42
7.	DEPARTAMENTI I FINANCAVE.....	43
7.1.	Analiza e shpenzimeve.....	43
7.2.	Planifikimi i shpenzimeve – 2026–2028.....	44
7.3.	Treguesit kryesorë të performancës – 2026–2028.....	45
7.4.	Analiza SWOT.....	47
8.	PLANI I ZHVILLIMIT TË STAFIT.....	49
8.1.	Numri i Punëtorëve 2026 – 2028.....	49
8.2.	Rritja e numrit të punëtorëve 2026-2028.....	50
8.3.	Punëtorët që do të pensionohen dhe angazhimi i stafit të ri (2026–2028).....	51
9.	INVESTIMET KAPITALE.....	52
9.1.	Investimet me mjete vetanake nga KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A.....	52
9.2.	Investimet nga Komunitat në zonën e shërbimit të KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A.....	54
9.3.	Investimet nga Qeveria dhe Donacionet – 2026–2028.....	57

10. PLANIFIKIMI I PASQYRAVE E TË ARDHURAVE 2025-2025 .....	59
11. ORGANOGRAMI .....	61

### Lista e figurave

Figura 1. Harta e zonës së shërbimit K.R.U “Hidroregjioni-Jugor”Sh.A - Prizren .....	8
Figura 2. Tarifat e pritshme për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura 2026 .....	14
Figura 3. Tarifat sipas Aplikimit Tarifor për vitin 2026 .....	14
Figura 4. Diferenca mes tarifave aktuale 2025 me tarifrat e reja 2026 dhe aplikimit tarifor 2026 .....	15
Figura 5. Parashikimi i prodhimit vjetor të ujit (2026–2028). .....	25
Figura 6. Trajtimi i ujit të ndotur në KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A, (2026–2028). .....	34
Figura 7. Parashikimi i numrit të konsumatorëve (2026–2028). .....	36
Figura 8. Diagrami i planifikimit të faturimit për periudhën 2026 - 2028 (m3) .....	37
Figura 9. Diagrami i planifikimit të faturimit për periudhën 2026 - 2028 (€) .....	38
Figura 10. Diagrami i planifikimit të të ardhurave për periudhën 2026 - 2028 (€) .....	39
Figura 11. Diagrami i planifikimit të shpenzimeve për periudhën 2026 - 2028 (€) .....	44

### Lista e tabelave

Tabela 1. Tarifat për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura 2025 .....	12
Tabela 2. Tarifat e pritshme për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura 2026-2028 .....	14
Tabela 3. Tarifat e pritshme për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura 2026-2028 .....	14
Tabela 4. <i>Tarifat e pritshme për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura – (Ndryshimi 2025-2026)</i> ...	15
Tabela 5.: Tarifa e kyçjes për përforcimin e infrastrukturës për ujë dhe ujëra të zeza .....	15
Tabela 6. Tarifa aktuale fikse dhe e propozuar për kyçje në rrjetin e ujësjellësit dhe rrjetin e ujërave të zeza me qëllim të përforcimit të infrastrukturës për vitet 2026- 2028 (viti bazë 2025) .....	16
Tabela 7. Prodhimi 2026-2028 .....	25
Tabela 8. Investimet me mjete vetanake DUN, 2026-2028 .....	33
Tabela 9. Investimet nga grandet dhe donacionet DUN, 2026-2028 .....	33
Tabela 10. Trajtimi i ujit të ndotur, projeksioni, DUN, 2026-2028 .....	34
Tabela 11. Numri i konsumatorëve 2026-2028 .....	36
Tabela 12. Planifikimi i të ardhurave nga faturimi për periudhën 2026 - 2028 (m <sup>3</sup> ) .....	37
Tabela 13. Planifikimi i të ardhurave nga faturimi për periudhën 2026 - 2028 (€) .....	38
Tabela 14. Planifikimi i Arkëtimit (€) 2026–2028 .....	39
Tabela 15. Planifikimi i Shpenzimeve (€) 2026–2028 .....	44
Tabela 16. Treguesit e Performancës (€) 2026–2028 .....	45

Tabela 17. Treguesit e Performancës II (€) 2026–2028.....	45
Tabela 18. Treguesit e Performancës Kryesore 2026–2028 .....	46
Tabela 19. Treguesit e Performancës (€) 2026–2028 .....	49
Tabela 20. Rritja e numrit të punëtorëve 2026–2028.....	50
Tabela 21. Nr. i punëtorëve që do të penzionohen 2026–2028.....	51
Tabela 22. Tabela e investimeve kapitale me mjete vetanake 2026–2028 .....	53
Tabela 23. Tabela e investimeve kapitale me mjete nga komunat 2026–2028.....	55
Tabela 24. Tabela e investimeve kapitale me mjete nga qeveria dhe donatorët 2026–2028 .....	57

**SHKURTESAT**

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
ME	Ministria e Ekonomisë
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë
KK	Kuvendi Komunal
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjellësit
DUP	Departamenti i ujit të pijes
NJOU	Njësia Operative e Ujësjellësit
NJPMNP	Njësia për Politika e Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
BD	Bordet e Drejtorëve
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
KfW	Banka gjermane për zhvillim
UPF	Uji i pa-faturuar
OSH	Ofruesit e Shërbimeve
GIS (SIG)	Sistemi Informativ Gjeografik
SHUKOS	Shoqata e Ujësjellësve dhe Kanalizimit të Kosovës
ITUN	Impiant i Trajtimit të Ujërave të Ndotura
UNMIK	Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë

**Përkufizimet**

**Aktivitetet e shërbimit:** Aktivitetet e identifikueshme individualisht të cilat duhet bërë ndaras në mënyrë që të ofrohen shërbimet për ujë dhe ujëra të zeza, që janë: resurset dhe trajtimi i ujit, distribuimi i ujit, mbledhja e ujërave të zeza, trajtimi i ujërave të zeza dhe trajtimi dhe deponimi/hedhja e llumit.

**Grantet:** Mjetet e dhëna financiare për investime ose për ofrim të shërbimeve në rastet kur shlyerja/ri-pagesa nuk kërkohet.

**Inventari i Aseteve:** Databazë e të gjitha asetëve të ujit dhe asetëve fikse të ujërave të zeza me të cilat një kompani operon. Kjo databazë është e ndryshme, dhe nuk duhet të ngatërrohet me, regjistrin e asetëve që mbahet për qëllime të kontabilitetit. Inventari i asetëve përmban të dhënat bazë të asetit plus gjendjen e asetit, të dhënat për mirëmbajtje dhe kostot.

**Kërkesat për të ardhura:** Kërkesa vjetore për të ardhura të nevojshme për të financuar aktivitetet e KRU, duke përfshirë kthimin në kapital. Këtu përfshihen kostot operative; ripërtëritja e infrastrukturës; zhvlerësimi sipas kostos aktuale; kthimi në BRA dhe sipas përshtatshmërisë edhe shpenzimet tjera.

**Mirembajtja kapitale:** Puna e planifikuar e kryer nga KRU për të zëvendësuar dhe riparuar asetet e furnizimit me ujë dhe të ujërave të zeza e për të siguruar një shërbim bazik për konsumatorët.

**Plani i biznesit:** Dokument i cili i paraqitet për miratim Bordit të Drejtorëve, pronarëve të KRU dhe ARRU, përcakton aktivitetet e planifikuara dhe kostot e shoqëruara (kapitale dhe operative), që gjithashtu është pjesë e aplikacioneve tarifore të KRU të cilat parashtrihen në ARRU.

**Rritja kapitale:** Për të rritur dhe ngritur bazën e asetëve përmes niveleve të ngritura të shërbimit dhe/ose zgjerimit të sistemit.

**Shpenzimet operative:** Shpenzime direkte operative që ndërlidhen me ofrimin e shërbimeve, duke përfshirë: punën; energjinë; kimikatet; materialet harxhuese; shpenzimet; taksat e pakthyeshme dhe shpenzimet e tjera.

1. Mbulueshmëria




Figura 1. Harta e zonës së shërbimit K.R.U “Hidroregjioni-Jugor”Sh.A - Prizren

## 2. HYRJE

Plani i Biznesit për periudhën 2026–2028 përfaqëson dokumentin kryesor strategjik të Kompanisë, i cili përcakton caqet zhvillimore dhe objektivat kryesore për trevjeçarin e ardhshëm. Ky plan është përgatitur mbi bazën e Modullit të Planifikimit të Caqeve, i cili mundëson planifikimin dhe monitorimin e performancave në baza mujore dhe vjetore për të gjitha njësitë punuese të Kompanisë.

Gjatë hartimit të këtij plani janë angazhuar të gjitha shërbimet përkatëse të Kompanisë, duke siguruar një proces gjithëpërfshirës dhe koordinim të plotë ndërmjet njësive operative, teknike, financiare dhe administrative. Një rëndësi e veçantë i është kushtuar planifikimit mujor të performancave, veçanërisht atyre operative dhe financiare, për të garantuar një pasqyrë të saktë të progresit dhe realizimit të caqeve.

Forma dhe struktura e përgatitjes së këtij Plani të Biznesit janë harmonizuar me kërkesat e Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim (ARRU), si dhe me standardet e raportimit të institucioneve të tjera relevante kombëtare e ndërkombëtare. Qëllimi themelor i modullit të planifikimit është të mundësojë kontroll të vazhdueshëm të performancës dhe arritjes së caqeve në çdo nivel organizativ – nga shërbimet individuale, tek njësitë punuese, e deri në nivelin rajonal të Kompanisë.

Ky plan përcakton në mënyrë të qartë orientimet zhvillimore, objektivat strategjikë dhe rezultatet e pritshme, duke u mbështetur në analizën e performancës së periudhës paraprake. Përgatitja e planit është bërë duke marrë në konsideratë gjendjen ekzistuese të Kompanisë, trendët e zhvillimit të sektorit të ujit në Kosovë dhe jashtë saj, si dhe adoptimin e praktikave më të mira ndërkombëtare për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe efikas të Kompanisë.

Plani i Biznesit 2026–2028 përfaqëson vazhdimësi të drejtimit zhvillimor të periudhës 2025–2027, duke reflektuar përparësitë, sfidat dhe rreziqet që ndikojnë në realizimin e suksesshëm të objektivave. Analiza e parametrave financiarë dhe operativë është bërë me kujdes, duke u siguruar që ata të jenë realistë, të arritshëm dhe me potencial për tejkalim, në përputhje me kapacitetet aktuale të Kompanisë.

Ky plan është gjithashtu i orientuar drejt institucioneve financiare dhe donatorëve ndërkombëtarë, pasi zbatimi i tij, veçanërisht në segmentin e investimeve kapitale, është i lidhur ngushtë me mbështetjen që do të sigurohet nga këto institucione, si dhe nga organet qendrore e lokale të qeverisjes.

Nëpërmjet këtij plani, Kompania synon të arrijë vetëqëndrueshmëri financiare, përmirësim të cilësisë së shërbimeve, optimizim të burimeve, si dhe rritje të efikasitetit në të gjitha nivelet e funksionimit.

### 3. PËRMBLEDHJA E PËRGJITHSHME

#### 3.1 Historiku i Kompanisë

Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. ka një histori të gjatë të zhvillimit dhe transformimit institucional që nga fillimi i veprimtarisë së saj në vitin 1962, kur operonte si ndërmarrje shoqërore me emrin “Cvileni”.

Pas vitit 1999, kompania ka funksionuar si Ndërmarrje Publike nën administrimin e DSHP – Shtylla IV e UNMIK-ut, ndërsa në mesin e vitit 2003 është regjionalizuar duke përfshirë katër njësi operative: Prizren, Suharekë, Dragash dhe Malishevë.

Që nga korriku i vitit 2007, kompania funksionon si Shoqëri Aksionare – KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A.

##### 3.1.1. Fusha e shërbimeve

“Hidroregjioni Jugor” ofron shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit në pjesën jugore të Kosovës, duke mbuluar këto komuna:

- Komuna e Prizrenit: Qyteti i Prizrenit dhe 35 fshatra (nga gjithsej 72 fshatra)
- Komuna e Suharekës: Qyteti i Suharekës dhe 20 fshatra (nga gjithsej 42 fshatra)
- Komuna e Dragashit: Qyteti i Dragashit dhe 3 fshatra (nga gjithsej 38 fshatra)
- Komuna e Malishevës: Qyteti i Malishevës dhe 18 fshatra (nga gjithsej 44 fshatra)
- Komuna e Mamushës: Mamusha<sup>1</sup>

Rrjeti furnizues i Kompanisë përfshin katër njësi operacionale që korrespondojnë me katër komunat kryesore të mbuluara: Prizren, Suharekë, Dragash dhe Malishevë.

##### 3.1.2. Burimet dhe kapacitetet furnizuese

Furnizimi me ujë kryhet kryesisht nga burime vetanake, ndërsa në nivel të Kompanisë 64 fshatra janë të lidhura direkt me rrjetin rajonal të furnizimit në zonat e Prizrenit, Suharekës dhe Malishevës.

Numri i përgjithshëm i popullsisë së mbuluar nga shërbimet e Kompanisë vlerësohet të jetë rreth 200,000 banorë.

Kapacitetet prodhuese përfshijnë si burime natyrore ashtu edhe puse të shpimit, të cilat përbëjnë një alternativë të rëndësishme për sigurimin e vazhdueshëm të ujit.

Aktualisht, një pjesë e burimeve nuk është e shfrytëzuar me kapacitet të plotë, ndërsa 45% e furnizimit realizohet përmes pompimit dhe 55% me gravitet, duke siguruar një shpërndarje të balancuar dhe efikase të ujit për zonat e mbuluara.

<sup>1</sup> ARRU ka pezulluar licensën për komunën e Mamushës

### 3.2 Baza Ligjore

Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidroregjioni Jugor” Sh.A., me seli në Prizren, është e organizuar në formën e shoqërisë tregtare aksionare, ku të gjitha aksionet janë në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Kompania ushtron veprimtarinë e saj operative dhe financiare në përputhje me kuadrin ligjor të Republikës së Kosovës dhe detyrimet që rrjedhin nga aktet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, si më poshtë:

- Ligji nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shoqëritë Tregtare;
- Ligji nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike;
- Ligji nr. 04/L-111 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike;
- Ligji nr. 05/L-009 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-111;
- Ligji nr. 03/L-086 për Afruesit e Shërbimeve të Ujit dhe të Mbeturinave;
- Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike;
- Ligji nr. 04/L-116 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë;
- Ligji nr. 04/L-147 për Ujërat;
- Ligji nr. 03/L-212 për Punën;
- Ligji nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale; dhe
- Ligji nr. 03/L-064 për Festat Zyrtare.

### 3.3 Deklarata e Politikës

Menaxhmenti i KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A., në bashkëpunim të ngushtë me Bordin e Drejtorëve, aksionarët, konsumatorët dhe me mbështetjen e plotë të të gjithë punëmarrësve, ka për qëllim sigurimin e furnizimit të pandërprerë dhe cilësor me ujë të pijshëm për të gjithë konsumatorët brenda zonës së shërbimit të Kompanisë.

Për arritjen e këtij objektivi strategjik, Kompania do të mobilizojë të gjitha burimet njerëzore, teknike dhe financiare, me synim:

- Minimizimin e humbjeve teknike dhe administrative të ujit,
- Rritjen e efikasitetit operativ, dhe
- Maksimizimin e shkallës së arkëtimit të të hyrave nga shërbimet e ofruara.

Përmes zbatimit të këtyre masave, Kompania synon të krijojë kushte të favorshme për rritjen e kapaciteteve investuese nga burimet vetanake, duke përmirësuar qëndrueshmërinë financiare dhe operacionale.

Përmbushja e këtij vizioni do të krijojë parakushte të qëndrueshme për tërheqjen e investimeve të reja nga donatorët ndërkombëtarë dhe institucionet financiare, duke forcuar më tej bazën zhvillimore dhe perspektivën afatgjatë të Kompanisë.

### 3.4 Tarifat e shërbimit

Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. do të zbatojë tarifën e çmimeve të miratuara nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-086 për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit. ARRU është autoriteti i vetëm dhe kompetent për përcaktimin dhe miratimin e tarifave për ofruesit e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit në Republikën e Kosovës.

Bazuar në këtë kornizë rregullative, është përcaktuar parimi themelor i mbulimit të plotë të kostove të operimit dhe investimeve, i cili synon të sigurojë që tarifën të pasqyrojnë realisht kostot e shërbimeve dhe të garantojnë funksionim financiarisht të qëndrueshëm të Kompanisë.

Tarifat e miratuara nga ARRU do të përdoren për mbulimin e shpenzimeve operative, rritjen e kapaciteteve investuese dhe bashkëfinancimin e projekteve kapitale në bashkëpunim me komunat përkatëse, komunitetin dhe donatorët ndërkombëtarë.

Zbatimi i politikës tarifore pritet të ndikojë pozitivisht në performancën financiare të Kompanisë, duke motivuar menaxhmentin dhe stafin për përmbushjen me sukses të misionit për ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme, cilësore dhe të besueshme për konsumatorët.

Tabela 1. Tarifat aktuale për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura 2025

Kategoria e konsumatorit	Tarifa fikse (Euro/muaj)	Tarifa volumetrike për ujë të pijes (Euro/m <sup>3</sup> )	Tarifa volumetrike të ujërave të ndotura (Euro/ m <sup>3</sup> )
Konsumatori Shtëpiak	1.0	0.40	0.15
Komercial/Industrial	2.0	0.56	0.32
Komercial/Industrial	2.0	0.56	0.32

Duke qenë se tarifën për periudhën 2026–2028 ende nuk janë miratuar nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), të gjitha projeksionet dhe planifikimet financiare në këtë Plan të Biznesit janë bazuar në aplikimin tarifor të dorëzuar nga Kompania. Këto projeksione përfaqësojnë vlerësime të përafërta të ardhurash dhe shpenzimesh, të hartuara në përputhje me parimin e mbulimit të plotë të kostove dhe me performancën e pritur operacionale e financiare për periudhën e ardhshme.

Në përgatitjen e projeksioneve janë marrë parasysh të gjithë faktorët që ndikojnë në strukturën ekonomike të Kompanisë, përfshirë inflacionin e pritur, ndryshimet në kostot e energjisë elektrike, mirëmbajtjen e infrastrukturës, pagat e punëmarrësve, si dhe planin e investimeve kapitale për zgjerimin dhe modernizimin e rrjetit. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar vlerësimit të kapacitetit pagues të konsumatorëve dhe ndikimit të mundshëm që do të kenë tarifën e reja në stabilitetin financiar të Kompanisë.

Pas marrjes së vendimit final nga ARRU, Kompania do të kryejë rishikimin dhe harmonizimin e projeksioneve financiare me tarifat e miratuara zyrtarisht. Ky proces do të mundësojë që planifikimet operative dhe buxhetore të jenë të përafuara me të hyrat reale dhe kostot e miratuara, duke siguruar kështu përputhje të plotë ndërmjet objektivave të vetëqëndrueshmërisë financiare dhe zhvillimit të qëndrueshëm të shërbimeve. Gjithashtu, Kompania do të zbatojë mekanizma të brendshëm për monitorimin e zbatimit të projeksioneve financiare, përmes raportimit periodik mujor dhe vjetor, me qëllim të vlerësimit të progresit ndaj caqeve të vendosura. Në rast të ndryshimeve të konsiderueshme në treguesit ekonomikë ose në strukturën tarifore, plani financiar do të përshtatet për të reflektuar realitetin e ri ekonomik dhe për të ruajtur balancën ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve.

Kjo qasje e bazuar në planifikim dinamik dhe menaxhim të kujdesshëm financiar siguron që Kompania të veprojë në përputhje me vendimet rregullative në fuqi, duke forcuar besueshmërinë institucionale dhe transparencën financiare. Si rezultat, KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. do të mund të ruajë stabilitetin e saj financiar, të përmirësojë performancën operacionale dhe të krijojë kushte më të favorshme për investime të reja në sektorin e ujësjellësit dhe kanalizimit në rajonin e saj të shërbimit.

### 3.4.1. Tarifat e planifikuara

ARRU, në proceset e kaluara tarifore, ka qenë përgjithësisht konservative sa i përket rritjes së tarifave. Me qëllim të uljes së koeficientit të ndërfinancimit midis kategorive të konsumatorëve, ajo ka zbatuar politika që shpesh kanë rezultuar me zbritje të tarifave për konsumatorët jo-shtëpiakë, ndërkohë që gjatë procesit tarifor 2025 nuk janë marrë plotësisht në konsideratë disa kategori të shpenzimeve të operimit.

Në anën tjetër, për shkak të rritjes së kostove të energjisë elektrike, pagave dhe mëditjeve (si rezultat i shtimit të numrit të punëtorëve), si dhe taksave mjedisore e ndërtimore, është evidentuar nevoja për rritje të moderuar të tarifave për periudhën 2026–2028.

Bazuar në këto faktorë, kompania ka paraparë këtë rritje të pritshme të tarifave:

- Për konsumatorët shtëpiakë (amvisëri): +0.10 €/m<sup>3</sup> për ujin e pijshëm dhe +0.10 €/m<sup>3</sup> për ujërat e ndotura – që paraqet një rritje mesatare prej rreth 36.4%.
- Për konsumatorët komercialë dhe institucionalë: +0.14 €/m<sup>3</sup> për ujin e pijshëm dhe +0.07 €/m<sup>3</sup> për ujërat e ndotura – që përfaqëson një rritje mesatare prej rreth 23.9%.

Këto ndryshime kanë për qëllim balancimin e shpenzimeve operative reale, ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare të kompanisë, si dhe sigurimin e cilësisë së vazhdueshme të shërbimeve për të gjitha kategoritë e konsumatorëve.

Tabela 2. Tarifatat e pritshme për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura 2026-2028<sup>2</sup>

Kategoria e konsumatorit	Tarifa volumetrike për ujë të pijes (Euro/ m <sup>3</sup> )	Tarifa volumetrike të ujërave të ndotura (Euro/ m <sup>3</sup> )
Konsumatori Shtëpiak	0.50	0.25
Komercial/Industrial	0.70	0.39
Institucional	0.70	0.39




Figura 2. Tarifatat e pritshme për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura 2026

Tabela 3. Tarifatat, sipas aplikimit tarifar për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura 2026-2028<sup>3</sup>

Kategoria e konsumatorit	Tarifa volumetrike për ujë të pijes (Euro/ m <sup>3</sup> )	Tarifa volumetrike të ujërave të ndotura (Euro/ m <sup>3</sup> )
Konsumatori Shtëpiak	0.68	0.18
Komercial/Industrial	0.89	0.34
Institucional	0.89	0.34




Figura 3. Tarifatat sipas Aplikimit Tarifar për vitin 2026

<sup>2</sup> Të dhënat e paraqitura më sipër janë përgatitur bazuar në aplikimin tarifar për periudhën 2026–2028 dhe përfaqësojnë projeksione të përafërta që do të harmonizohen pas vendimit final të ARRU-së.

<sup>3</sup> Të dhënat e paraqitura më sipër janë përgatitur bazuar në aplikimin tarifar për periudhën 2026

Tabela 4. Tarifat e pritshme për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura – (Ndryshimi 2025-2026)

Kategoria e konsumatorit	Tarifa volumetrike për ujë të pijes (Euro/m3) 2025	Tarifa volumetrike për ujë të pijes (Euro/m3) 2026	Tarifa volumetrike të ujërave të ndotura (Euro/m3) 2025	Tarifa volumetrike të ujërave të ndotura (Euro/m3) 2026	Total 2025	Total 2026	Ndry. %
Konsumatori Shtëpiak	0.40	0.50	0.15	0.25	0.55	0.75	36.4%
Konsumatori komercial/institucional	0.56	0.70	0.32	0.39	0.88	1.09	23.9%




Figura 4. Diferenca mes tarifave aktuale 2025 me tarifatat e reja 2026 dhe aplikimit tarifor 2026

Tabela 5.: Tarifa e kyçjes për përforcimin e infrastrukturës për ujë dhe ujëra të zeza

Tarifa e kyçjes për përforcimin e infrastrukturës për ujë dhe ujëra të zeza	Nj.	2025	2026	2027	2028
Ujë	€	NA	130.00	130.00	130.00
Ujërat e ndotura	€		90.00	90.00	90.00

Tabela 6. Tarifa aktuale fikse dhe e propozuar për kyçje në rrjetin e ujësjellësit dhe rrjetin e ujërave të zeza me qëllim të përrforcimit të infrastrukturës për vitet 2026- 2028 (viti bazë 2025)

Diametri i kyçjes në rrjetin shpërndarës	Nj.	2025	2026	2027	2028
15mm	€	Deri në vitin 2025 Tarifa fikse ka qenë 1,00 € për konsumatorët shtëpiak dhe 2,00 € për konsumatorët jo shtëpiak	1.25	1.25	1.25
20mm	€		1.25	1.25	1.25
25mm	€		2.00	2.00	2.00
32mm	€		2.00	2.00	2.00
40mm	€		8.10	8.10	8.10
50mm	€		8.10	8.10	8.10
65mm	€		20.00	20.00	20.00
80mm	€		20.00	20.00	20.00
100mm	€		24.60	24.60	24.60
125mm	€		24.60	24.60	24.60
150mm	€		38.80	38.80	38.80
200mm	€		38.80	38.80	38.80
250mm	€		54.00	54.00	54.00

### 3.4.2. Pasojat dhe arsyeshmëria e rritjes së tarifës

Trendi i rritjes të parashikuar të tarifave volumetrike për familjet përshpejtohet nga harmonizimi i tarifave midis konsumatorëve shtëpiak dhe konsumatorëve jo shtëpiak deri në fund të periudhës së ardhshme të planifikimit (si rezultat i rënies së koeficientit të ndër financimit). Konsumatorët jo shtëpiak do të shohin një rritje më të ulët si rezultat i kësaj. Shkaku kryesor i rritjes është rritja e pritur e kostove të energjisë elektrike si rezultat i liberalizimit të tregut që ka filluar më 01.05.2025 përfshirë edhe disa nga kategoritë tjera të shpenzimeve.

Përveç kësaj, komponentët e tarifës fikse do të aplikohen sipas udhëzimeve të rregullatorit ekonomik, të cilat bazohen në diametrin e lidhjes. Për familjet, kjo mund të nënkuptojë një ndryshim të vogël krahasuar me situatën deri në fund të vitit 2025. Klientët me lidhje më të mëdha do të paguajnë relativisht më shumë përmes komponentit të tarifës fikse sesa më parë.

### 3.4.3. Përballueshmëria

Duke përdorur tarifën e parashikuar, mund të parashikohet zhvillimi i përballueshmërisë së shërbimit. Për familjet me të ardhura më të ulëta, apo rastet sociale, tarifën për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza është qartësisht më e lartë. Megjithatë, pritet që ne të ardhmen këto raste të mbulojë ministria perkatese.

## 4. DEPARTAMENTI I UJIT TË PIJES (DUP)

Departamenti i Ujit të Pijes (DUP) ushtron përgjegjësinë dhe fushëveprimtarinë e saj kryesisht në tre divizione kryesore:

1. Planifikimi dhe zhvillimi teknik
2. Prodhimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm
3. Zvogëlimi i ujit pa faturim (UPF) – humbjet e ujit

### 4.1. Qëllimet

KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. ka përcaktuar objektivat strategjike për periudhën 2026–2028, të cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të performancës operative, financiare dhe shërbimeve ndaj konsumatorëve. Qëllimet kryesore janë:

- Zgjerimi i zonës së shërbimit deri në 96% të mbulimit, me synim rritjen e përqindjes së popullsisë me qasje në shërbime të ujit të pijshëm dhe kanalizimit, duke respektuar kriteret mjedisore dhe duke ndikuar pozitivisht në mirëqenien socio-ekonomike të komuniteteve brenda zonës së shërbimit.
- Sigurimi i shfrytëzimit racional dhe të qëndrueshëm të burimeve të ujit. Sigurimi i furnizimit të vazhdueshëm me ujë për konsumatorët ekzistues dhe ata të rinj, 24 orë në ditë, me presion të rregulluar sipas standardeve për të gjitha zonat, përfshirë edhe zonat me vështirësi në furnizim.
- Ofrimi i ujit të pijshëm me cilësi të garantuar, në përputhje me standardet e IKSHPK-së, duke synuar 100% pajtueshmëri të testeve të ujit.
- Zgjerimi i zonës së shërbimit në trajtimin e ujërave të ndotura përmes planifikimit dhe inicimit të projekteve për ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura (ITUN) parciale dhe qendrore.
- Promovimi i marrëdhënieve të mira dhe bashkëpunimit të ndërsjellë me konsumatorët.
- Sigurimi i afarizmit rentabil dhe vetëqëndrueshmërisë financiare përmes rritjes së normës së mbulimit të kostove operative.
- Rritja e vlerës së aseteve të Kompanisë gjatë periudhës 2026–2028.
- Zbatimi i plotë i rregulloreve të ARRU-së, përfshirë standardet minimale të shërbimeve, licencimin, Kartën e Konsumatorit dhe politikën tarifore, me qëllim sigurimin e cilësisë së shërbimeve dhe arritjen e të ardhurave të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve operative dhe investimeve të planifikuara.
- Përmirësimi dhe avancimi i dukshëm i sistemit të furnizimit me ujë.
- Kontrolli i vazhdueshëm i cilësisë së ujit dhe presionit në përputhje me standardet në fuqi.
- Zvogëlimi optimal i humbjeve teknike dhe komerciale të ujit.
- Reduktimi i shpenzimeve operative për mirëmbajtje dhe operim.
- Shtimi dhe avancimi i shërbimeve të Kompanisë për konsumatorët.

- Parandalimi i ndotjes së ujit të pijshëm nga ujërat e zeza përmes menaxhimit të sigurt dhe kontrollit sanitar të rrjeteve.

## 4.2. Objektivat

### 4.2.1. Objektivat kryesore

- Sigurimi i funksionimit të plotë dhe efikas të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit. Mirëmbajtja e rregullt dhe operimi i pandërprerë i infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit.
- Sanimi i shpejtë dhe cilësor i prishjeve në rrjetet e ujësjellësit dhe kanalizimit. Zhvillimi i strategjive dhe aktiviteteve të qëndrueshme për zvogëlimin e humbjeve të ujit të pijshëm, me theks të veçantë në vendosjen e ujëmatësve në pronë publike për të parandaluar keqpërdorimet.
- Zbatimi i plotë i projekteve të planifikuara për periudhën 2026–2028, me fokus të veçantë në vitin e parë të zbatimit.
- Zonimi i sistemit të ujësjellësit dhe menaxhimi hidraulik për të garantuar furnizim sipas standardeve të kërkuara.
- Krijimi dhe mirëmbajtja e zonave DMA dhe aplikimi i modelimeve hidraulike për analizë teknike dhe uljen e humbjeve teknike e administrative.
- Sigurimi i kushteve të favorshme dhe të sigurta të punës për të gjithë punëmarrësit.
- Furnizimi me pajisje dhe stabilimente të teknologjisë moderne që përmbushin kërkesat e shëndetit, sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit.
- Regjistrimi, ruajtja dhe menaxhimi elektronik e fizik i të dhënave të Kompanisë përmes një Sistemi Informativ Menaxhues funksional.
- Monitorimi i saktë i prodhimit, furnizimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura përmes ujëmatësve dhe sistemeve SCADA.
- Avancimi i sistemit GIS për të mbuluar tërë zonën e shërbimit dhe përgatitja e Planit të Menaxhimit të Aseteve.
- Operimi i plotë i Sistemit të Mirëmbajtjes dhe Operimit (MMS) dhe Aplikacionit Mobil të Menaxhimit (MMA).
- Rritja e transparencës në raportim ndaj Menaxhmentit, Bordit të Drejtorëve dhe palëve të interesit.
- Finalizimi i dokumenteve strategjike në proces, përfshirë Planin e Menaxhimit të Krizave dhe Planin e Menaxhimit të Rrezikut.

### 4.2.2. Aktivitetet e planifikuara për realizimin e objektivave

Aktivitetet e planifikuara janë të orientuara në zbatimin e projekteve të përcaktuara në këtë Plan Biznes, të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejt në përmbushjen e caceve të Kompanisë:

- Zbatimi i projekteve investive në përputhje me Planin e Biznesit dhe planin vjetor të investimeve.
- Pjesëmarrja financiare dhe mbështetja profesionale për projektet e planifikuara nga institucionet lokale, qendrore dhe donatorët.
- Operimi optimal i shërbimeve teknike për furnizim të qëndrueshëm dhe cilësor me ujë të pijshëm.
- Mirëmbajtja e rregullt e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit.
- Intervenimi efikas, profesional dhe në kohë në sanimin e prishjeve, me qëllim uljen e humbjeve të ujit.
- Instalimi i ujëmatësve të prodhimit dhe zonal në të gjitha pikat prodhuese dhe shpërndarëse për monitorim të saktë të prodhimit dhe furnizimit.
- Instalimi i ujëmatësve për të gjithë konsumatorët, duke siguruar faturim sipas konsumit real.
- Zhvendosja e ujëmatësve ekzistues nga prona private në pronë publike për të parandaluar keqpërdorimet.
- Hartimi i studimit të fizibilitetit për implementimin e sistemit SCADA për monitorimin e avancuar teknik-operacional të rrjetit të furnizimit me ujë.
- Avancimi profesional i ekipeve të mirëmbajtjes elektroteknike, mekanike dhe hidraulike.
- Azhurnimi dhe pasurimi i sistemit GIS me të dhëna të reja teknike dhe gjeohapësinore.
- Trajnimi dhe ngritja profesionale e stafit në fushat e trajtimit të ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotura.
- Zbatimi i rregulloreve të ARRU-së dhe udhëzimeve administrative për menaxhimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, si kusht për operimin e ITUN-eve.
- Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore përmes trajnimeve profesionale, pjesëmarrjes në konferenca dhe shkëmbimit të përvojave me operatorë vendorë dhe ndërkombëtarë.
- Zbatimi i dokumenteve strategjike për menaxhimin e rreziqeve dhe emergjencave, përfshirë:

1. Planin e Menaxhimit të Thatësirave
2. Planin e Furnizimit me Ujë të Pijshëm në Situata Emergjente
3. Planin Afatgjatë të Investimeve
4. Planin e Menaxhimit të Rrezikut
5. Planin e Menaxhimit të Krizave
6. Planin e Menaxhimit të Aseteve
7. Strategjinë për Zvogëlimin e Humbjeve të Ujit
8. Planin e Veprimit për Zvogëlimin e Humbjeve Teknike të Ujit të Pijshëm

### 4.3. Rreziqet që mund të ndikojnë në mosarritjen e caqeve

- Ndryshimet klimatike dhe thatësitrat e zgjatura që ndikojnë drejtpërdrejt në uljen e kapaciteteve të burimeve ujore, reduktimin e prodhimit dhe vështirësitë në furnizim gjatë periudhave kritike.
- Rritja e çmimeve të energjisë elektrike, materialeve dhe shërbimeve që ndikon në rritjen e kostove operative dhe në uljen e efikasitetit financiar të Kompanisë.
- Mosrealizimi i investimeve të planifikuara në Planin e Biznesit si rezultat i mungesës së fondeve ose vonesave në proceset e prokurimit dhe zbatimit.
- Prolongimi i projekteve bashkëfinancuese për shkak të vonesave apo dështimeve në përmbushjen e obligimeve nga institucionet qendrore, komunat dhe agjencionet financiare partnere.
- Ndikimet e mundshme nga fatkeqësi natyrore, pandemia apo ngjarje të jashtëzakonshme që mund të ndërpresin aktivitetet operationale, zinxhirin e furnizimit apo planifikimet financiare.
- Ulja e efikasitetit operativ në sanimin e prishjeve që mund të ndikojë në cilësinë e ujit të pijshëm, presionin në rrjet dhe sigurimin e furnizimit të pandërprerë për konsumatorët, si dhe në përmbushjen e standardeve minimale të shërbimit.
- Moszbatimi i plotë i legjislacionit në fuqi dhe mungesa e ndjekjes ligjore të shkelësve që mund të krijojë vështirësi në zbatimin e masave disiplinore ndaj keqpërdoruesve të shërbimeve dhe dëmtuesve të rrjetit.
- Mungesa e legjislacionit plotësues dhe mekanizmave efektivë të zbatimit që kufizojnë mundësitë për ndëshkimin e konsumatorëve abuzues dhe mbrojtjen ligjore të aseteve publike.

### 4.4. Plani i investimeve kapitale

Plani i Investimeve përbën një pjesë të rëndësishme të Planit të Biznesit, pasi i mundëson Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. të përmirësojë dhe avancojë shërbimet ndaj konsumatorëve, duke kontribuar njëkohësisht në ndërgjegjësimin qytetar për pagesën e faturave dhe përfshirjen aktive në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të ujit.

Plani i investimeve përbëhet nga disa kategori projektesh dhe burimesh financiare, me theks të veçantë në:

- përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës ujore,
- zgjerimin e zonave të shërbimit,
- zvogëlimin e humbjeve teknike dhe komerciale, dhe
- avancimin e programeve monitoruese, menaxhuese dhe operative të Kompanisë (p.sh. GIS, SCADA, MMS, MMA).

Në varësi të mundësive buxhetore dhe vlerave të përcaktuara nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), janë identifikuar tri kategori kryesore projektsh:

- Projekte me financim vetanak nga Kompania;
- Projekte me bashkëfinancim me agjencione dhe institucione financiare;
- Projekte kapitale madhore që tejkalojnë mundësitë buxhetore të Kompanisë dhe që lidhen me strategjitë zhvillimore lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe me burime të tjera donatore.

Qëllimi kryesor i Planit të Investimeve është përcaktimi i orientimeve zhvillimore në përputhje me misionin dhe vizionin e Kompanisë, duke ndërtuar një kuadër të qartë strategjik për menaxhimin e aseteve dhe investimeve afatgjata.

Përzgjedhja e projekteve investive është bazuar në:

- infrastrukturën ekzistuese dhe të dhënat e disponueshme,
- dokumentet analitike dhe financiare,
- elaboratet e fizibilitetit dhe studimet teknike,
- raportet periodike dhe auditimet vjetore,
- vlerësimet e licencuara të gjendjes së aseteve, dhe
- programet operacionale dhe të mirëmbajtjes së Kompanisë.

Një komponentë e rëndësishme e këtij procesi është harmonizimi i projekteve investive me strategjitë zhvillimore komunale dhe qendrore, si dhe me projektet e mbështetura nga donatorët dhe institucionet financiare.

Potencialet financiare të planifikuara për investime kapitale pritet të sigurohen nga burimet e mëposhtme:

- Linjat buxhetore të investimeve kapitale të komunave të Prizrenit, Suharekës, Malishevës dhe Dragashit;
- Projektet kapitale të përfshira në strategjitë nacionale (ME, MF, MIE, MMPHI, etj.) dhe në programet bashkëfinancuese si PIP apo të ngjashme;
- Mjetet vetanake të Kompanisë;
- Grantet nga institucionet financiare zhvillimore dhe agjencionet që përkrahin sektorin e ujit, si BERZH, KfW, BE, SDC, GIZ, Banka Botërore dhe të tjera organizata ndërkombëtare që mbulojnë këtë fushë veprimtarie.

#### **4.5. Përtëritja dhe rritja e infrastrukturës**

Rajoni i Prizrenit dhe zona menaxhuese e Kompanisë karakterizohen nga një rrjet i vjetër i ujësjellësit dhe kanalizimit, i ndërtuar në periudha të ndryshme kohore, kryesisht gjatë viteve

'60 (dhe pjesërisht edhe më herët), me materiale të amortizuara dhe standarde teknike të tejkaluara.

Nevojat për investime në këtë drejtim janë shumë të mëdha dhe të domosdoshme, por kërkojnë kosto të konsiderueshme. Ky proces mund të realizohet pjesërisht nga Kompania me mjete vetanake, ndërsa zbatimi i plotë është i mundur vetëm përmes përfshirjes dhe mbështetjes së institucioneve lokale e qendrore, institucioneve financiare zhvillimore dhe donatorëve ndërkombëtarë.

Realizimi i këtyre investimeve do të bëhet në faza të planifikuara, në përputhje me mundësitë financiare dhe me prioritetet e përcaktuara nga analizat teknike dhe planifikimet strategjike të Kompanisë.

Përcaktimi i prioriteteve dhe nevojave emergjente për ripërtëritjen e infrastrukturës së ujësjellësit bazohet në:

- raportet dhe analizat teknike të rrjetit ekzistues,
- studimet e segmenteve me prishje të shpeshta,
- zonat me humbje të larta teknike ose lidhje ilegale,
- segmentet me presion jashtë standardeve të lejuara, dhe
- zonat ku rrjetet janë të amortizuara ose paraqesin rrezik për cilësinë e ujit dhe shëndetin publik.

Me zgjerimin e zonës së shërbimit, në përputhje me marrëveshjet dhe praktikat ekzistuese, parashihen gjithashtu investime në linja të reja furnizuese, burime të reja ujore, si dhe aftësime dhe rehabilitime të rrjeteve ekzistuese jofunksionale.

Plani i detajuar i investimeve për periudhën 2026–2028 është i paraqitur në shtesën e veçantë të këtij dokumenti.

#### **4.6. Planifikimi i zvogëlimit të humbjeve të ujit**

Një nga sfidat më serioze të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. mbetet zvogëlimi i humbjeve të ujit, me theks të veçantë në humbjet teknike. Realizimi i këtij objekti kërkon angazhim të plotë institucional dhe bashkëpunim ndërmjet të gjitha departamenteve të Kompanisë, si dhe mbështetje të konsiderueshme financiare për zbatimin e projekteve përkatëse.

Bazuar në matjet e realizuara dhe raportet zyrtare mbi prodhimin dhe përqindjen e humbjeve të ujit të pijshëm, krahasuar me parametrat e përcaktuar nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), sipas planifikimeve të këtij Plani të Biznesit synohet që deri në

fund të vitit 2028 humbjet e ujit të reduktohen nga 76.12% në 67.50%, që përfaqëson një zvogëlim prej rreth 3 % në baza vjetore.

Për këtë qëllim, Kompania ka planifikuar të përforcojë sektorin për UPF. Është hartuar Strategjia për Zvogëlimin e Humbjeve të Ujit të Pijshëm, e cila përfshin një Plan Veprimi me masa konkrete për identifikimin, kontrollin dhe eliminimin e burimeve të humbjeve. Rekomandohet që ky dokument strategjik të azhurnohet dhe përshtatet me objektivat e procesit tarifar 2026–2028, në përputhje me udhëzimet e ARRU-së.

Në përputhje me këto rekomandime, investimet në zvogëlimin e humbjeve të ujit duhet të arrijnë të paktën 1/3 e buxhetit total vjetor të investimeve kapitale të Kompanisë. Në këtë drejtim, janë planifikuar dhe përzgjedhur projekte prioritare që përfshijnë:

- Zëvendësimin e rrjeteve të amortizuara dhe të vjetruara të ujësjellësit.
- Avancimin e teknologjive depërtuese dhe implementimin e metodave moderne për detektimin permanent të rrjedhjeve të ujit.
- Evidentimin në kohë dhe intervenimin efikas në sanimin e rrjedhjeve nëntokësore dhe mbitokësore.
- Prioritizimin e intervenimeve në segmentet problematike bazuar në të dhënat e programeve aplikative MMS dhe MMA.
- Instalimin dhe zëvendësimin e ujëmatësve të prodhimit dhe atyre zonal në të gjitha pikat prodhuese dhe shpërndarëse të rrjetit, për të mundësuar monitorim të saktë të prodhimit dhe furnizimit me ujë.
- Instalimin e ujëmatësve për të gjithë konsumatorët, me qëllim që faturimi të bëhet bazuar në konsumin real.
- Dislokimin e ujëmatësve ekzistues nga prona private në pronë publike, sa më afër pikës së furnizimit, për të parandaluar keqpërdorimet dhe ndërhyrjet e paautorizuara në rrjet.
- Intensifikimin e aktiviteteve për përfundimin e incizimit gjeodezik dhe digjitalizimin e rrjetit të ujësjellësit, përditësimin e të dhënave në AutoCAD dhe integrimin e tyre në sistemin GIS.
- Zbatimin e zonimit DMA dhe modelimeve hidraulike për monitorim të presioneve dhe bilancit hidrik.
- Planifikimin dhe zhvillimin e kapaciteteve njerëzore përmes trajnimeve profesionale dhe avancimeve teknike në fushën e menaxhimit të rrjedhjeve, matjeve dhe analizës hidraulike.

Zbatimi i suksesshëm i këtij plani do të kontribuojë drejtpërdrejt në përmirësimin e efikasitetit operativ, uljen e kostove, rritjen e qëndrueshmërisë financiare dhe sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm me ujë të pijshëm për të gjithë konsumatorët brenda zonës së shërbimit.

#### 4.7. Plani i menaxhimit të aseteve

Gjendja aktuale e aseteve të Kompanisë është vlerësuar nga operatori ekonomik i licencuar gjatë vitit 2020, në përputhje me kriteret dhe standardet përkatëse të fushës. Duke pasur parasysh rezultatet e këtij vlerësimi, konstatohet se përgjatë viteve të kaluara nuk ka pasur një planifikim të mirëfilltë për menaxhimin e aseteve, dhe për pasojë gjendja e tyre është vlerësuar si jo plotësisht e kënaqshme.

Pas përfundimit të luftës, janë realizuar një sërë investimesh që kanë ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e gjendjes së aseteve dhe të performancës së Kompanisë. Këto investime kanë përfshirë rehabilitimin dhe ndërtimin e rezervuarëve të rinj, rrjetet e ujësjellësit, instalimin e fazonerive, ujëmatësve të profileve të ndryshme, pajisjeve të punës dhe makinerive që kanë kontribuar në rritjen e kapaciteteve të prodhimit dhe përmirësimin e cilësisë së ujit.

Në kuadër të përmirësimit të menaxhimit të aseteve, me mbështetjen dhe udhëzimet e ARRU-së, Kompania ka hartuar Planin Bazë për Menaxhimin e Aseteve, i cili është miratuar nga ARRU dhe ka filluar zbatimin gjatë vitit 2024.

Duke u bazuar në analizat teknike dhe të dhënat operative, Kompania ka përcaktuar objektivat dhe prioritetet e saj për një menaxhim më efikas të aseteve, të cilat përfshijnë:

- Incizimin gjeodezik, digjitalizimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, modelimin hidraulik, përditësimin e të dhënave në sistemin AutoCAD dhe integrimin e tyre në GIS.
- Kompletimin e regjistrimit të aseteve përmes përdorimit të aplikacioneve të avancuara softuerike dhe pajisjeve harduerike, duke u bazuar në regjistrimet vjetore dhe në raportin përfundimtar të rivlerësimit të aseteve të realizuar nga operatori i licencuar në vitin 2020.
- Inçizimin, vlerësimin dhe regjistrimin e aseteve të reja pas përfundimit të projekteve investive të financuara nga donatorët dhe gjatë procesit të marrjes në menaxhim të zonave të reja të shërbimit.
- Procedimin final të asgjësimit të aseteve me amortizim të plotë dhe çregjistrimin e tyre nga librat kontabël të Kompanisë.
- Sistemimin adekuat të materialeve dhe pjesëve përcjellëse sipas specifikave teknike dhe destinimit, përfshirë pajisjen e tyre me fletëregjistrim dhe barkod për identifikim.
- Vendosja, sistemimi dhe mbrojtja e duhur e pajisjeve dhe materialeve që ndodhen jashtë objekteve të depozitimeve, nga ndikimet mekanike, fizike dhe atmosferike.
- Plotësimi i rregullativës së brendshme për adresimin e qartë të përgjegjësive dhe zbatimin e saktë të procedurave të punës nga personat përgjegjës.
- Planifikimi dhe përgatitja e dokumentacionit për projektet investive, si dhe avancimi i resurseve njerëzore me qëllim realizimin e projekteve dhe aktiviteteve operative.

#### 4.8. Prodhimi (m<sup>3</sup>) 2026–2028

Prodhimi i ujit për periudhën 2026–2028 përbën një nga treguesit themelorë të performancës teknike dhe operacionale të Kompanisë. Të dhënat për prodhimin bazohen në matjet mujore të realizuara në burimet ujore, stacionet e pompimit, si dhe në përlllogaritjet vjetore të raportuara nga njësitë punuese.

Planifikimet për këtë periudhë janë orientuar drejt ruajtjes së qëndrueshmërisë së furnizimit me ujë, rritjes së efikasitetit energjetik dhe përdorimit racional të burimeve ujore. Këto synime mbështeten në zbatimin e masave për reduktimin e humbjeve, rehabilitimin e burimeve ekzistuese dhe modernizimin e sistemeve teknike të prodhimit.

Të dhënat për prodhimin e ujit janë përgatitur nga Njësia e Prodhimit, sipas planifikimeve vjetore dhe objektivave të përcaktuara në këtë Plan Biznes.

Tabela 7. Prodhimi 2026-2028

2026-2028						
K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN						
No.	Të dhënat	2024	2025	2026	2027	2028
		m <sup>3</sup>	m <sup>3</sup>	m <sup>3</sup>	m <sup>3</sup>	m <sup>3</sup>
	NJËSIA P.					
1	PRIZREN	23,354,070	27,479,473	27,479,473	27,203,944	26,711,106
2	SUHAREKË	4,473,192	4,593,999	4,562,915	4,562,915	4,632,890
3	MALISHEVË	2,441,429	2,542,629	2,573,076	2,573,076	2,573,076
4	DRAGASH	917,439	823,019	836,365	836,365	779,279
	TOTAL	31,186,130	35,439,119	35,451,828	35,176,300	34,696,351
	NDRYSHIMI		4,252,989	12,709	(275,529)	(479,949)
	NDRY. %		13.64%	0.04%	-0.78%	-1.36%




Figura 5. Parashikimi i prodhimit vjetor të ujit (2026–2028).

Koment mbi prodhimin e ujit për periudhën 2026-2028:

Në përgatitjen e rishikimit të Planit të Biznesit për periudhën 2026–2028, është parashikuar një rënie e sasisë së prodhimit të ujit, e cila mbështetet në zvogëlimin e humbjeve të ujit, veçanërisht ato teknike.

Rënia e burimeve ujore në fund të vitit 2024 dhe fillim të vitit 2025 – Si pasojë e kushteve klimatike dhe ndryshimeve sezonale, është evidentuar një ulje e prurjeve në disa nga burimet kryesore të ujit. Për të kompensuar këtë rënie dhe për të garantuar vazhdimësinë e furnizimit, gjatë gjatshëmujorit të parë është bërë përshtatja e kapaciteteve prodhuese me nevojat reale të konsumit.

1. Ndërprerja e aplikimit të reduktimeve – Me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe rritjen e kënaqshmërisë së konsumatorëve, kompania ka ndërprerë masat e reduktimit të furnizimit me ujë në zonat ku ato aplikoheshin më parë. Kjo ka sjellë rritje të konsumit ditor dhe, si rezultat, është rritur nevoja për sasi më të madhe uji të prodhuar.
2. Vendosja e ujëmatësit në pikën hyrëse nga Rezervuari Shpati (tek 34-shi për qytet) – Me qëllim kontrollin më të saktë të bilancit të ujit dhe matjen e sasisë së ujit të shpërndarë drejt qytetit, është instaluar një ujëmatës në këtë pikë kyçe. Kjo ndërhyrje ka mundësuar një pasqyrë më reale të volumit aktual të shpërndarë dhe ka theksuar nevojën për rritje të prodhimit për të përmbushur kërkesën faktike të konsumit.
3. Rritja e numrit të konsumatorëve – Gjatë vitit 2025 është evidentuar një rritje e vazhdueshme e numrit të konsumatorëve të rinj, gjë që ka ndikuar në rritjen e kërkesës për ujë dhe ka imponuar nevojën për kapacitete më të mëdha prodhuese në periudhën pasuese.

Këta faktorë të kombinuar përbëjnë bazën për përditësimin e të dhënave në Planin e Biznesit dhe për parashikimin e kapaciteteve të nevojshme për prodhimin dhe menaxhimin efikas të ujit gjatë periudhës 2026–2028.

Pasqyrimi i projeksionit të prodhimit për periudhën 2025–2028 është bazuar kryesisht në:

- Matjen sa më reale të prodhimit gjatë tremujorëve II dhe III të vitit 2025;
- Zbatimin e strategjive dhe planeve të veprimit për zvogëlimin e humbjeve të ujit, menaxhimin e aseteve dhe avancimin e teknologjive softuerike e harduerike.

#### **4.9. Aktivitetet për zvogëlimin e UPF-së**

Aktivitetet për zvogëlimin e ujit pa faturim (UPF) do të rishikohen dhe plotësohen në përputhje me zhvillimet teknike, investimet dhe rezultatet e arritura. Qëllimi kryesor është fuqizimi i kapaciteteve të brendshme, përmes konsolidimit të divizionit për UPF, Departamentit për Ujin e Pijshëm dhe Departamentit Komercial, hartimit të Strategjisë 2026–2028 për zvogëlimin e humbjeve, si dhe zbatimit të Planit të Veprimit për këtë fushë.

Projeksioni i përcaktuar për përqindjen e zvogëlimit të humbjeve teknike të ujit gjatë periudhës 2026–2028 është mbështetur në faktorët vijues:

- Strategjia 2026–2028 për zvogëlimin e humbjeve të ujit;
- Plani i Veprimit 2026 për ndërmarrjen e aktiviteteve të drejtpërdrejta nga Departamenti Komercial dhe Departamenti i Ujit të Pijshëm, në bashkëpunim me të gjitha departamentet përkatëse të Kompanisë;
- Realizimi i projekteve të përcaktuara në Planin e Biznesit për investimet kapitale
- Promovimi i efikasitetit të brendshëm dhe ndërgjegjësimit të konsumatorëve për përdorim racional të ujit.

Megjithatë, realizimi i përqindjes së synuar për zvogëlimin e humbjeve gjatë periudhës 2026–2028 mbetet një sfidë e ndjeshme, veçanërisht në aspektin teknik dhe financiar, për shkak të:

- Rrjetit të ujësjellësit dhe infrastrukturës së amortizuar, në gjendje të pavolitshme teknike;
- Kostove shumë të larta për investime në rehabilitim dhe zvogëlim të humbjeve teknike;
- Mundësive të kufizuara buxhetore të Kompanisë për zbatim të plotë të projekteve kapitale të planifikuara në Planin e Biznesit.

Në përputhje me prioritetet dhe mundësitë financiare, planifikohen të zbatohen dy faza kryesore të aktiviteteve:

#### **Faza e parë**

- Riparimi efektiv i rrjedhjeve të dukshme;
- Detektimi sistematik i rrjedhjeve të padukshme dhe riparimi i tyre;
- Rehabilitimi dhe zëvendësimi i rrjeteve të vjetruara me asistencën e donatorëve;
- Definimi dhe krijimi i zonave të reja të matura (DMA);
- Menaxhimi i presioneve në rrjetin e furnizimit.

#### **Faza e dytë**

- Monitorimi i humbjeve në zonat e matura;
- Përcaktimi i saktë i bilancit ujqor;
- Menaxhimi i presioneve për optimizim të furnizimit;
- Rehabilitimi sistematik i rrjetit dhe kyçjeve shtëpiake.

Zbatimi i këtyre fazave do të mundësojë uljen graduale të humbjeve, përmirësimin e performancës teknike dhe operative, si dhe rritjen e qëndrueshmërisë financiare të Kompanisë në përputhje me standardet e përcaktuara nga ARRU.

## 5. DEPARTAMENTI I UJËRAVE TË NDOTURA (DUN)

### 5.1. Fushë veprimtaria e Departamentit të Ujërave të Ndotura

Departamenti i Ujërave të Ndotura dhe Impianteve për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (UN–ITUN) në kuadër të KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. ka një fushë veprimtarie që përfshin një sërë aktivitete të ndërlidhura me menaxhimin e sistemit të kanalizimit dhe trajtimin e ujërave të ndotura në nivel rajonal.

Në kuadër të kompetencave të tij, departamenti ushtron këto përgjegjësi kryesore:

- Grumbullimin e ujërave të ndotura në qytetet e Prizrenit, Suharekës, Malishevës dhe Dragashit përmes sistemeve ekzistuese dhe atyre të reja që janë në ndërtim e sipër;
- Mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrjeteve të kanalizimit në zonat urbane dhe rurale, duke siguruar funksionalitet të plotë dhe parandalimin e derdhjeve të pakontrolluara;
- Konsolidimin e sistemeve ekzistuese të kanalizimit dhe planifikimin e zgjerimeve të reja në nivel rajonal;
- Trajtimin e ujërave të ndotura përmes impianteve ekzistuese dhe atyre që janë në proces ndërtimi ose planifikimi;
- Konsolidimin dhe planifikimin e impianteve të reja, si qendrore ashtu edhe parciais, për të përmbushur nevojat e komunave të mbuluara nga Kompania;
- Monitorimin e vazhdueshëm të shkarkimeve industriale dhe konsolidimin e rrjeteve të ndotura në nivel rajonal;
- Garantimin e respektimit të parametrave të efluentit në përputhje me direktivat dhe udhëzimet në fuqi që përcaktojnë standardet e lejuara të shkarkimit në trupat ujore pritëse.

Aktualisht, KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. operon me Impiantin për Trajtimin e Ujërave të Ndotura në qytetin e Prizrenit dhe është në procedurë të marrjes së menaxhimit të Impiantit të Bukoshit në Suharekë dhe të Impiantit të Kukit në Dragash.

### 5.2. Qëllimet dhe objektivat kryesore

Departamenti i Ujërave të Ndotura dhe Impianteve për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (UN–ITUN) ka për qëllim sigurimin e funksionimit të qëndrueshëm, efikas dhe mjedisor të sistemeve të kanalizimit dhe impianteve në nivel rajonal, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Objektivat kryesore të këtij departamenti për periudhën 2026–2028 përfshijnë:

- Zgjerimin e zonës së shërbimit me sisteme të ujërave të ndotura deri në 80% të popullsisë së mbuluar;

- Ndërtimin dhe funksionalizimin e impianteve të reja për trajtimin e ujërave të ndotura, duke arritur mbulueshmërinë deri në 20%;
- Sigurimin e shfrytëzimit racional dhe efikas të sistemeve për grumbullim, transport dhe trajtim të ujërave të ndotura;
- Ofrimin e shërbimeve të kanalizimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në përputhje me standardet teknike dhe rregulloret e miratuara nga institucionet përkatëse;
- Zbatimin e planeve të mirëmbajtjes për monitorim, pastrim dhe kontroll të vazhdueshëm të sistemeve të ujërave të ndotura, të hartuara nga HRJ dhe të miratuara nga ARRU;
- Hartimin e master planeve për sistemet e kanalizimit në nivel rajonal në bashkëpunim me komunat përkatëse;
- Zbatimin e kushteve teknike për kyçjen e konsumatorëve në sistemin publik të kanalizimit;
- Përfundimin e procesit të digjitalizimit dhe përditësimit të të dhënave për rrjetin e kanalizimit në nivel rajonal;
- Identifikimin dhe kontrollin e kyçjeve në sistemin publik të kanalizimit përmes testimeve “smoke test”;
- Monitorimin dhe kontrollin e gjendjes së rrjetit me anë të inspektimeve CCTV;
- Realizimin e modelimeve hidraulike për analizimin e kapaciteteve të pellgjeve ujëmbledhëse të ujërave të ndotura;
- Përditësimin e kadastres së ndotësve industrialë në nivel rajonal;
- Promovimin e efikasitetit të energjisë dhe përdorimin e burimeve të energjisë së ripërtitshme në sistemet e trajtimit të ujërave të ndotura;
- Avancimin e sistemeve të automatizimit dhe integrimin e tyre në sistemet e informacionit për menaxhim operativ;
- Adoptimin e plotë të rregulloreve të ARRU-së, përfshirë Standardet Minimale të Shërbimeve, Rregulloren e Licencimit, Kartën e Konsumatorit dhe Politikën Tarifore, për sigurimin e cilësisë së shërbimeve dhe mbulimin e kostove operative e investimeve të domosdoshme.

### 5.3. Aktivitetet e planifikuara me qëllim të arritjes së caqeve

Aktivitetet e planifikuara të Departamentit të Ujërave të Ndotura dhe ITUN janë të fokusuara në realizimin e projekteve të parashikuara në Planin e Biznesit 2026–2028, të cilat do të kontribuojnë drejtpërdrejt në përmbushjen e objektivave strategjike të Kompanisë.

Në këtë kuadër, janë planifikuar aktivitetet në vijim:

- Krijimi i grupeve punuese në bashkëpunim me komunat përkatëse për hartimin e master planeve të kanalizimit dhe impianteve rajonale;

- Hartimi i doracakut teknik që përcakton kushtet dhe kriteret për kyçjen e konsumatorëve në sistemin publik të kanalizimit;
- Identifikimi dhe regjistrimi i konsumatorëve që shkarkojnë ujëra të ndotura në rrjet pa pasur konsum të ujit nga kompania;
- Formimi i grupit punues ndërinstitucional për monitorimin e ndotësve industrialë dhe kontrollin e shkarkimeve;
- Zbatimi i Procedurave Standarde të Operimit (PSO) dhe manualeve përkatëse për funksionimin dhe mirëmbajtjen e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura në nivel rajonal;
- Monitorimi i cilësisë së ujërave të ndotura në hyrje dhe dalje të impianteve, në përputhje me standardet mjedisore kombëtare dhe direktivat e BE-së;
- Trajnimi dhe ngritja profesionale e stafit teknik në fushën e menaxhimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, përfshirë menaxhimin e emergjencave dhe mirëmbajtjen parandaluese;
- Rritja e vetëdijes publike për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit përmes fushatave informuese, debateve publike, pjesëmarrjes në media dhe aktiviteteve edukative me nxënës të shkollave.

Këto aktivitete synojnë të sigurojnë funksionim të qëndrueshëm, menaxhim të përgjegjshëm dhe përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve të kanalizimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në të gjitha komunat e mbuluara nga KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A.

#### **5.4. Rreziqet që mund të ndikojnë në mosarritjen e caqeve**

Rreziqet që mund të ndikojnë në mosrealizimin e objektivave dhe caqeve të planifikuara për periudhën 2026–2028 janë të shumta dhe lidhen kryesisht me faktorë teknikë, financiarë dhe institucionalë. Ndër më kryesoret përmenden:

- Mosrealizimi i investimeve të parapara në Planin e Biznesit;
- Prolongimi ose dështimi i projekteve për shkak të vonesave në financim nga agjencitë vendore dhe ndërkombëtare, veçanërisht në rastet e bashkëfinansimit;
- Mospërcaktimi i hartimit të master planeve si prioritet nga komunat përkatëse;
- Mospërbushja e rregulloreve teknike për kyçje në sistemin publik të kanalizimit dhe vazhdimi i kyçjeve ilegale;
- Ndërprerjet ose luhatjet e tensionit në furnizimin me energji elektrike, që ndikojnë në funksionimin e impianteve;
- Mungesa e mbikëqyrjes së rregullt të projekteve të përbashkëta me komunat;
- Mungesa e bashkëpunimit efektiv me palët e interesit;
- Ndikimi i forcave madhore, në veçanti përmbytjet e mundshme nga reshjet atmosferike;
- Mosrealizimi i investimeve nga komunat apo donatorët përkatës.

Këto rreziqe kërkojnë menaxhim proaktiv, koordinim të vazhdueshëm ndërinstitucional dhe masa parandaluese për të siguruar stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e projekteve të planifikuara.

### 5.5. Plani investiv

Plani i investimeve për periudhën 2026–2028 synon përmirësimin e infrastrukturës së kanalizimit dhe ndërtimin e impianteve të reja për trajtimin e ujërave të ndotura, duke rritur efikasitetin dhe qëndrueshmërinë mjedisore.

Ai është hartuar në përputhje me dokumentet e reja strategjike, si:

- Plani i Investimeve Afatgjata 2018–2028;
- Planet Zhvillimore Komunale dhe buxhetet vjetore;
- Strategjia e Ujërave 2023–2027 dhe Plani i saj i Veprimit;
- Strategjia e Energjisë 2022–2031;
- Studimi i Fizibilitetit për Ujërat e Ndotura 2011–2035 (Fichtner, KfW).

Investimet do të fokusohen në rehabilitimin e rrjeteve ekzistuese, ndërtimin e impianteve të reja, modernizimin teknologjik dhe zbatimin e zgjidhjeve efikase energjetike. Prioritetet janë përcaktuar sipas nevojave teknike dhe mjedisore, me përfshirje të komunave, institucioneve qendrore dhe donatorëve ndërkombëtarë.

### 5.6. Përtëritjet e infrastrukturës

Investimet e planifikuara për periudhën 2026–2028 fokusohen në përtëritjen e infrastrukturës së kanalizimit, me theks në zëvendësimin e sistemeve jofunksionale në zonat e vjetra urbane. Këto investime do të përmirësojnë ndjeshëm shërbimet e mirëmbajtjes dhe trajtimit të ujërave të ndotura në përputhje me standardet mjedisore, do të rrisin numrin e konsumatorëve dhe do të ulin shpenzimet energjetike.

Plani përfshin edhe ndërtimin e rrjeteve të reja në zona ku ende mungon kanalizimi, duke reduktuar ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe rrezikun nga epidemitë. Gjithashtu, synohet vendosja e sistemeve për trajtimin paraprak të ujërave të zeza, në përputhje me kërkesat e Bashkimit Evropian.

Këto ndërhyrje, ndonëse kërkojnë investime të konsiderueshme, do të mbështeten nga Qeveria e Kosovës, komunat përkatëse dhe donatorët ndërkombëtarë si KfW dhe Banka Botërore.

### 5.7. Rritje e infrastrukturës

Investimet e planifikuara për rritjen e infrastrukturës gjatë periudhës 2026–2028 kanë për qëllim furnizimin me makineri dhe pajisje të reja që do të shërbejnë për konsolidimin dhe mirëmbajtjen efikase të sistemeve të kanalizimit dhe impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura.

Këto investime do të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, uljen e shpenzimeve operative dhe energjetike, rritjen e numrit të konsumatorëve dhe zgjerimin e zonës së shërbimit.

Në kuadër të Planit të Biznesit janë paraparë edhe investime për zgjerimin e rrjetit të kanalizimit, përfshirë inkuadrimin e sistemeve që aktualisht vetëmenaxhohen nga komunitetet lokale, si dhe ndërtimin e rrjeteve të reja në zonat ku operon KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A.

Në koordinim me planet zhvillimore komunale dhe ato të përgjithshme urbane, do të planifikohen dhe harmonizohen investimet kapitale për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, me qëllim rritjen e mbulueshmërisë dhe përmirësimin e kushteve mjedisore.

### 5.8. Mirëmbajtja e infrastrukturës

Investimet e planifikuara për mirëmbajtjen e infrastrukturës gjatë periudhës 2026–2028 kanë për qëllim sigurimin e funksionimit të qëndrueshëm të pajisjeve elektromekanike në të gjitha fazat e procesit të punës së impianteve.

Në kuadër të Planit të Biznesit janë paraparë investime specifike për mirëmbajtjen e infrastrukturës ekzistuese, me fokus në zgjatjen e afatshërbimit dhe jetgjatësisë së pajisjeve elektromekanike në çdo fazë të ciklit operacional të ITUN-ve.

Këto masa synojnë të sigurojnë efikasitet më të lartë teknik, të reduktojnë ndërprerjet operative dhe të garantojnë funksionim të pandërprerë të sistemeve të trajtimit të ujërave të ndotura.

### 5.9. Aktivitetet biznesore

Investimet e planifikuara në kuadër të aktiviteteve biznesore për periudhën 2026–2028 kanë për qëllim zbatimin e standardeve minimale të shërbimeve, duke mundësuar kontrollin dhe pastrimin e sistemeve të kanalizimit në nivel rajonal.

Në Planin e Biznesit është paraparë furnizimi me cisternë thithëse–shtytëse, e cila do të përdoret për pastrimin dhe deblokimin e pusëve dhe rrjetit të kanalizimit, duke përmirësuar ndjeshëm efikasitetin e mirëmbajtjes.

Këto investime janë në përputhje me planet zhvillimore komunale dhe ato të përgjithshme urbane, duke synuar rritjen e mbulueshmërisë me shërbime të kanalizimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në koordinim me institucionet lokale dhe donatorët.

### 5.10. Investimet DUN

Tabela 8. Investimet me mjete vetanake DUN, 2026-2028

INVESTIMET KAPITALE NË SISTEMIN E KANALIZIMIT DHE IMPIANTE PËR TRAJTIM TË UJËRAVE TË NDOTURA NË DEPARTAMENTIN UN - (2026-2028)					
	INVESTIMET NGA MJETET VETANAKE				
Nr	VITET	2025	2026	2027	2028
1	NJ.P. PRIZREN	302,516.00	400,000.00	265,000.00	345,000.00
2	NJ.P.- SUHAREKË	0	55,000.00	130,000.00	145,000.00
3	NJ.P. - MALISHEVË	0	50,000.00	115,000.00	105,000.00
4	NJ.P. - DRAGASH	0	25,000.00	45,000.00	45,000.00
<b>KRU,, HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A</b>		<b>302,516.00</b>	<b>530,000.00</b>	<b>555,000.00</b>	<b>640,000.00</b>

Tabela 9. Investimet nga grantet dhe donacionet DUN, 2026-2028

INVESTIMET KAPITALE NË SISTEMIN E KANALIZIMIT DHE IMPIANTE PËR TRAJTIM TË UJËRAVE TË NDOTURA NË DEPARTAMENTIN UN - (2026-2028)					
	INVESTIMET NGA GRANDET/ DONACIONET				
Nr	VITET	2025	2026	2027	2028
1	NJ.P. PRIZREN	2,809,097.83	2,500,000.00	2,500,000.00	2,050,000.00
2	NJ.P.- SUHAREKË	400,000.00	430,000.00	500,000.00	300,000.00
3	NJ.P. - MALISHEVË	660,000.00	300,000.00	500,000.00	300,000.00
4	NJ.P. - DRAGASH	340,900.00	100,000.00	200,000.00	100,000.00
<b>KRU,, HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A</b>		<b>4,209,997.83</b>	<b>3,330,000.00</b>	<b>3,700,000.00</b>	<b>2,750,000.00</b>

#### Koment 1:

Sa i përket investimeve të planifikuara nga komunat, grantet dhe qeveria për ujërat e ndotura, projektet janë paraqitur në planifikim, megjithatë aktualisht nuk ekzistojnë marrëveshje të nënshkruara bashkëfinancimi me komunat përkatëse apo institucionet financiare.

#### Koment 2:

Projektet me mjete vetanake për vitin 2025 janë inicuar nga njësitë kërkuese, por janë shtyrë për shkak të mungesës së fondeve, konkretisht projektet me numër 15 dhe 17, sipas Planit të Biznesit të rishikuar për vitin 2025.

#### Koment 3:

Projektet e planifikuara për periudhën 2026–2028 në këtë Plan të Biznesit janë të harmonizuara plotësisht me projektet e përfshira në Aplikimin Tarifor për vitet 2026–2028, duke siguruar koherencë ndërmjet planifikimeve teknike, financiare dhe rregullatore.

### 5.11. Trajtimi i ujit të ndotur – m<sup>3</sup> (2026–2028)

Në kuadër të objektivave për përmirësimin e performancës mjedisore, KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. ka planifikuar rritje graduale të sasisë së ujërave të ndotura të trajtuara gjatë periudhës 2026–2028.

Tabela 10. Trajtimi i ujit të ndotur, projeksioni, DUN, 2026-2028

2026-2028					
K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A - PRIZREN					
No.	Të dhënat	2025	2026	2027	2028
		m <sup>3</sup>	m <sup>3</sup>	m <sup>3</sup>	m <sup>3</sup>
<b>NJËSIA PUNUESE</b>					
1	PRIZREN	3,911,722	3,915,634	3,919,549	3,923,469
2	SUHAREKË	94,000	94,000	94,000	94,000
<b>TOTAL:</b>		<b>4,005,722</b>	<b>4,009,634</b>	<b>4,013,549</b>	<b>4,017,469</b>

**Koment:**

Në impiantin biologjik të Bukshit (NJ.O. Suharekë) gjatë periudhës raportuese nuk janë realizuar shpenzime direkte financiare për procesin e trajtimit të ujërave të ndotura. Megjithatë, trajtim fizik dhe biologjik i ujit të ndotur është kryer në mënyrë të rregullt. Vëllimi i ujit të trajtuar në këtë impiant është vlerësuar në bazë të numrit të banorëve ekuivalent që mbulohen nga sistemi i kanalizimit dhe që dërgojnë ujërat e ndotura për trajtim në këtë impiant, duke reflektuar një vlerësim teknik të përafërt të kapacitetit të trajtimit aktual.




Figura 6. Trajtimi i ujit të ndotur në KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A, (2026–2028).

## 6. DEPARTAMENTI KOMERCIAL

Ky departament organizon, koordinon dhe monitoron të gjitha aktivitetet që lidhen me ofrimin e shërbimeve për konsumatorët. Përmes seksioneve të veta, ai synon të përmirësojë vazhdimisht performancën në shërbime dhe të sigurojë komunikim efektiv me të gjitha departamentet tjera të Kompanisë.

Departamenti ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për trajtimin dhe shpërndarjen e kërkesave dhe ankesave të konsumatorëve tek njësitë përkatëse përgjegjëse për zgjidhjen e tyre. Lexuesit në terren realizojnë leximin e ujëmatësve dhe njëkohësisht shtypin e dorëzojnë faturat tek konsumatorët. Ai gjithashtu organizon punën e arkave ku kryhen pagesat, duke siguruar që të gjitha të ardhurat të dorëzohen në arkën kryesore ose në llogaritë zyrtare të kompanisë.

Nëpërmjet ekipeve të inspektoratit, kryhen kontrole rutinë dhe të planifikuara për identifikimin e lidhjeve të paautorizuara, konsumatorëve ilegalë, legalizimin e tyre sipas rregulloreve të brendshme, inkasimin e borxheve, si dhe shkyçjet për mos pagesë. Departamenti pranon raportet nga terreni dhe ndërmerr veprime të menjëhershme kur është e nevojshme.

Gjithashtu, ai trajton kërkesat për kyçe të reja duke mbledhur dokumentacionin përkatës dhe duke i proceduar ato në departamentin kompetent. Departamenti udhëheq punën me konsumatorë në të gjitha njësitë operative (Suharekë, Malishevë dhe Dragash), duke koordinuar faturimin, arkimin, leximet, inspektoratin dhe shkyçjet.

Po ashtu, ky departament menaxhon procedurat për zgjidhjen e kontesteve me konsumatorët dhe bashkëpunon ngushtë me Komisionin për Zgjidhjen e Ankesave të ARRU-së. Ai pranon dhe shqyrton të gjitha ankesat dhe kërkesat komerciale në përputhje me politikat dhe rregulloret në fuqi.

KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. është e orientuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm të kënaqshmërisë së konsumatorëve, duke siguruar transparencë dhe bashkëpunim me të gjithë aktorët e sektorit të ujit në Kosovë dhe rajon. Departamenti për Konsumatorë do të vazhdojë të avancojë në ofrimin e shërbimeve përmes:

- mundësive të shumta për pagesa,
- qasjes elektronike në kartelat e konsumatorëve,
- përmirësimit të softuerëve dhe përditësimit të të dhënave,
- si dhe trajtimit efikas të ankesave brenda afateve ligjore.

## 6.1. Parashikimi i rritjes së numrit të konsumatorëve

Të tabelat vijuese mund të shihni parashikimin e rritjes së numrit të konsumatorëve të ndara në tri kategori: amvisëri, biznese dhe institucione.

## 6.2. Numri i konsumatorëve

Numri i përgjithshëm i konsumatorëve të K.R.U. “Hidroregjioni Jugor” SH.A. për periudhën 2025 sipas projeksionit arrin **64,792 konsumatorë**

Tabela 11. Numri i konsumatorëve 2026-2028

2026 - 2028						
No.	Të dhënat	2024	2025	2026	2027	2028
1	Shtëpiak	54,362	57,275	59,623	61,933	64,221
2	Ndryshimi		2,913	2,348	2,310	2,288
3	Ndryshi. %		5.36%	4.1%	3.9%	3.7%
4	Kome.-Indu.	6,864	7,161	7,426	7,743	8,009
5	Ndryshimi		297	265	317	266
6	Ndryshi. %		4.33%	3.7%	4.3%	3.4%
7	Institucional	355	356	357	359	361
8	Ndryshimi		1	1	2	2
9	Ndryshi. %		0.28%	0.3%	0.6%	0.6%
10	<b>TOTAL</b>	<b>61,581</b>	<b>64,792</b>	<b>67,406</b>	<b>70,035</b>	<b>72,591</b>
11	Ndryshimi		3,211	2,614	2,629	2,556
12	Ndryshi. %		5.2%	4.0%	3.9%	3.6%




Figura 7. Parashikimi i numrit të konsumatorëve (2026–2028).

### 6.3. Planifikimi i Faturimit (m3)

Në kuadër të Planit të Biznesit 2026–2028, është realizuar planifikimi i faturimit për periudhën 2026 - 2028, duke reflektuar rritjen të faturimit të konsumatorëve.

Tabela 12. Planifikimi i të ardhurave nga faturimi për periudhën 2026 - 2028 (m<sup>3</sup>)

2026-2028						
No.	Të dhënat	2024	2025	2026	2027	2028
1	Shtëpiak	7,222,613	7,060,436	8,212,894	9,095,006	9,845,295
2	Ndryshimi		(162,177)	1,152,458	882,112	750,289
3	Ndry. %		-2.2%	16.3%	10.7%	8.2%
4	Kome.-Indu.	836,377	848,289	888,567	959,887	975,569
5	Ndryshimi		11,912	40,278	71,320	15,682
6	Ndry. %		1.4%	4.7%	8.0%	1.6%
7	Institucional	485,020	554,912	439,387	457,723	455,849
8	Ndryshimi		69,892	(115,525)	18,336	(1,873)
9	Ndry. %		14.4%	-20.8%	4.2%	-0.4%
10	<b>TOTAL</b>	<b>8,544,010</b>	<b>8,463,637</b>	<b>9,540,848</b>	<b>10,512,616</b>	<b>11,276,714</b>
11	<b>Ndryshimi</b>		<b>(80,373)</b>	<b>1,077,211</b>	<b>971,768</b>	<b>764,098</b>
12	<b>Ndry. %</b>		<b>-0.9%</b>	<b>12.7%</b>	<b>10.2%</b>	<b>7.3%</b>




Figura 8. Diagrami i planifikimit të faturimit për periudhën 2026 - 2028 (m3)

### 6.4. Planifikimi i Faturimit (€) 2026-2028

Në kuadër të Planit të Biznesit 2026–2028, është realizuar planifikimi i faturimit për periudhën afatmesme, duke reflektuar rritjen graduale të të hyrave nga shërbimet me ujë dhe kanalizim.

Projekcionet janë bazuar në trendin historik të arkëtimeve, zgjerimin e zonës së shërbimit, rritjen e numrit të konsumatorëve dhe përmirësimin e efikasitetit në faturim dhe inkasim.

Tabela 13. Planifikimi i të ardhurave nga faturimi për periudhën 2026 - 2028 (€)

2026-2028						
No.	Të dhënat	2024	2025	2026	2027	2028
1	Faturimi-€	5,708,069.62	5,921,917.28	9,384,175.93	9,740,543.60	9,773,715.84
2	Total- Shte.	4,375,852.76	4,566,759.26	7,567,938.85	8,062,662.69	8,142,255.35
3	Ndryshimi		190,906.50	3,001,179.59	494,723.84	79,592.66
4	Ndry. %		4.36%	65.72%	6.54%	0.99%
5	Total- kome.	893,066.82	875,359.62	1,320,153.53	1,188,676.21	1,164,217.16
6	Ndryshimi		-17,707.20	444,793.91	-131,477.33	-24,459.05
7	Ndry. %		-1.98%	50.81%	-9.96%	-2.06%
8	Total-Inst.	439,150.04	479,798.40	496,083.55	489,204.71	467,243.33
9	Ndryshimi		40,648.36	16,285.15	-6,878.85	-21,961.37
10	Ndry. %		9.26%	3.39%	-1.39%	-4.49%
11	Te tjera	49,821.78	39,485.69	339,950.00	335,270.00	335,400.00
12	<b>Total</b>	<b>5,757,891.40</b>	<b>5,961,402.97</b>	<b>9,724,125.93</b>	<b>10,075,813.60</b>	<b>10,109,115.84</b>
13	Ndryshimi		203,511.57	3,762,722.96	351,687.67	33,302.24
14	Ndry. %		3.53%	63.12%	3.62%	0.33%




Figura 9. Diagrami i planifikimit të faturimit për periudhën 2026 - 2028 (€)

### 6.5. Planifikimi i Arkëtimit 2026-2028

Në kuadër të Planit të Biznesit 2026–2028, planifikimi i arkëtimit paraqet pritjet për rritje të qëndrueshme të të hyrave, si rezultat i përmirësimit të efikasitetit në inkasim, zgjerimit të zonës së shërbimit dhe zvogëlimit të borxheve të pambledhura.

Tabela 14. Planifikimi i Arkëtimit (€) 2026–2028

2027-2028						
No.	Të dhënat	2024	2025	2026	2027	2028
1	Total- Shtëpiak	4,664,059.38	4,690,559.38	7,265,221.29	7,820,782.81	8,060,832.79
2	Ndryshimi		26,500.00	2,574,661.91	555,561.51	240,049.99
3	Ndry. %		0.57%	54.89%	7.65%	3.07%
4	Total-Komercial-Industrial	994,350.11	920,696.24	1,320,153.53	1,188,676.21	1,164,217.16
5	Ndryshimi		-73,653.87	399,457.29	-131,477.33	-24,459.05
6	Ndry. %		-7.4%	43.4%	-10.0%	-2.1%
7	Total Institucional	402,390.04	447,144.21	496,083.55	489,204.71	467,243.33
8	Ndryshimi		44,754.17	48,939.34	-6,878.85	-21,961.37
9	Ndry. %		11.1%	10.9%	-1.4%	-4.5%
10	Total - ujë	6,060,799.53	6,058,399.83	9,081,458.38	9,498,663.72	9,692,293.29
11	Ndryshimi		-2,399.70	3,023,058.55	417,205.34	193,629.56
12	Ndry. %		0.0%	49.9%	4.6%	2.0%
13	Te tjera	40,824.10	32,164.40	339,950.00	335,270.00	335,400.00
14	Ndryshimi		-8,659.70	307,785.60	-4,680.00	130.00
15	Ndry. %		-21.2%	956.9%	-1.4%	0.0%
16	<b>TOTAL</b>	<b>6,101,623.63</b>	<b>6,090,564.23</b>	<b>9,421,408.38</b>	<b>9,833,933.72</b>	<b>10,027,693.29</b>
17	Ndryshimi		-11,059.40	3,330,844.15	412,525.34	193,759.56
18	Ndry. %		-0.18%	54.69%	4.38%	1.97%




Figura 10. Diagrami i planifikimit të të ardhurave për periudhën 2026 - 2028 (€)

## 6.6. Objektivat kryesore

- Ofrimi i shërbimeve ndaj konsumatorëve në përputhje me standardet minimale të shërbimit dhe rregulloret në fuqi.
- Rritja e numrit të konsumatorëve përmes përditësimit të bazës së të dhënave, duke përfshirë regjistrimin e pronës, ndryshimet e kategorive dhe modifikimet administrative.
- Zgjerimi i zonës së shërbimit me përfshirjen e zonave të reja rurale dhe lagjeve urbane, me qëllim rritjen e volumit të ujit të faturuar (m<sup>3</sup>).
- Arritja e caqeve të planifikuara për rritjen e faturimit dhe përmirësimin e nivelit të arkëtimit.

## 6.7. Aktivitetet kryesore të planifikuara për arritjen e objektivave nga Departamenti Komercial

- Leximi i rregullt i ujëmatësve dhe shpërndarja në kohë e faturave për të gjithë konsumatorët.
- Legalizimi i konsumatorëve të kyçur pa leje, sipas procedurave përkatëse të kompanisë.
- Azhurnimi i bazës së të dhënave me ndryshimet e reja për konsumatorët (emër, pronësi, kategori etj.).
- Kërkesa dhe ndjekja e rregullt e arkëtimit të faturave të shpërndara.
- Inicimi i rasteve përmbartimore ndaj konsumatorëve debitorë dhe ndërmarrja e masave për reduktimin e borxheve.
- Zgjerimi i zonës së shërbimit përmes marrjes në menaxhim të zonave të reja rurale dhe urbane, me faturim sipas tarifave të miratuara nga ARRU.
- Rritja e aktivitetit të lexuesve dhe ekipeve të inspektoratit për kontroll dhe presion ndaj konsumatorëve për pagesën e rregullt të shërbimeve.
- Dërgimi periodik i mesazheve njoftuese dhe komunikimeve telefonike për konsumatorët me borxhe të riprogramuara.
- Ndërmarrja e masave ligjore ndaj kyçjeve të paligjshme dhe rasteve të keqpërdorimit.
- Përmirësimi i komunikimit dhe marrëdhënieve me konsumatorët përmes transparencës dhe shërbimit më efikas.
- Organizimi i fushatave të vetëdijësimit publik në bashkëpunim me komunat, SHPK-në, gjykatat dhe mediat.

## 6.8. Gatishmëria për të paguar

Pagesat e faturave të shërbimeve të ujit realizohen përmes bankave komerciale, institucioneve mikrofinanciare, postës dhe arkave të kompanisë në njësitë operative. Aktualisht, sportelet funksionojnë në objektet e kompanisë dhe në disa lokacione komunale në Prizren dhe

Malishevë, ndërsa planifikohet zgjerimi edhe në zona të tjera për t'u ofruar konsumatorëve qasje më të lehtë në pagesa dhe në paraqitjen e ankesave.

Për konsumatorët me borxhe të akumuluar do të mundësohet ri-programimi dhe pagesa me këste mujore. Gjithashtu, planifikohet organizimi i kampanjave të vetëdijesimit për nxitjen e pagesave të rregullta dhe rritjen e nivelit të inkasimit.

### **6.9. Trendët e kërkesave më të shpeshta të konsumatorëve**

Një nga objektivat kryesore të Kompanisë për periudhën 2026–2028 mbetet rritja e të hyrave përmes arkëtimit të rregullt dhe faturimit të saktë të konsumatorëve, me synim sigurimin e vetëqëndrueshmërisë financiare dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.

Në këtë drejtim parashihen masa konkrete si:

- Zbatimi i plotë i kodit të mirësjelljes dhe etikës profesionale të stafit ndaj.
- Rotacioni i terreneve të inkasantëve për të shmangur familjarizimin me konsumatorët.
- Trajnimi i stafit për përmirësimin e komunikimit dhe shërbimit ndaj publikut.
- Funksionalizimi i zyrave pritëse për konsumatorë në të gjitha njësitë operative.
- Shqyrtimi i drejtë dhe i shpejtë i ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve.
- Leximi i rregullt dhe i saktë i ujëmatësve dhe penalizimi i mosrealizimit të leximit.
- Faturimi bazuar në konsumin real dhe eliminimi i faturimit paushall.
- Zbatimi i masave ligjore sipas rregullave të ARRU-së për konsumatorët borxhlinj.
- Arkëtimi i mjeteve përmes përmbauesve privat.
- Fuqizimi i ekipeve të inspektoratit dhe atyre të shkyçjeve me pajisje të nevojshme operative.
- Trajtimi i rasteve sociale në bashkëpunim me institucionet përkatëse.

### **6.10. Kërkesat e performancës së shërbimit ndaj konsumatorëve**

Avancimi i Zyrës Pritëse për Konsumatorë synon të ofrojë një shërbim më të afërt dhe efikas, ku çdo konsumator mund të regjistrojë ankesat apo kërkesat e tij përmes pranimit fizik në zyrë ose nëpërmjet linjës telefonike 24-orëshe. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave do të administrojë dhe trajtojë çdo rast në kohë sa më të shkurtër, duke garantuar transparencë dhe përgjigje profesionale.

Shërbimet digjitale tashmë përfshijnë dërgimin e faturave përmes emailit, paraqitjen online të ankesave dhe qasjen në kartelën personale të konsumatorit në ueb-faqen e kompanisë. Këto lehtësi synojnë të rrisin efikasitetin dhe kënaqësinë e konsumatorëve.

